


KOMISION PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE PËR AVANCIMIN E AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË ARSIM I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS (MASH)



PERCEPTIME PËR NDIKIMIN E AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË ARSIM (INA)



Më shumë se **7.900 të anketuar nga gjithsej 103 shkolla fillore dhe 30 shkolla të mesme** ishin pjesë e hulumtimit të zbatuar të Komisionit për Integrim Ndëretnik në Arsim të MASH-it.




75,6% e drejtorive të shkollave dhe bashkëpunëtorëve profesional shprehin perceptime dhe qëndrime pozitive për ndikimin e aktiviteteve të realizuara për integrim ndëretnik në drejtim të forcimit të kohezionit ndëretnik në arsimin.

AKTIVITETE PËR INA NË VITIN SHKOLLOR 2018/19

Matjet në përputhje me planin për matje të arritjeve (PMA) janë zbatuar me anë të dërgimit të pyetësorit gjër tek të gjitha shkollat fillore dhe të mesme




328 shkolla fillore dhe të mesme në vendin tonë kanë dërguar të dhëna për përcaktimin e arritjeve sipas indikatorëve të përcaktuar për integrim ndëretnik.



Më shumë se 22.700 nxënës kanë marrë pjesë në një aktivitet të përbashkët jashtëshkollor për integrim ndëretnik në arsim me nxënës të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, në kuadër të shkollës ose me shkollë partnere.



Llojet e aktiviteteve të përbashkëta jashtëshkollore të realizuara në të shumtën e rasteve janë si vijon: aktivitete sportive, seksione të përbashkëta të nxënësve, shëtitje, ekskursionet, vizita, ngjarje, kremtime dhe festa, aksione ekologjike dhe humanitare, punëtori multikulturore dhe aktivizëm rinor.



Më shumë se 11.700 nxënës të arsimit fillor dhe më shumë se 1.800 nxënës të arsimit të mesëm kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta në kuadër të orëve të rregullta me nxënës të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, të kryesuara prej mësimdhënësve në përputhje me gjuhën mësimore.



Aktivitete të përbashkëta mësimore në mësimin e rregullt realizohen kryesisht në lëndët mësimore: gjuhë të huaja, arsim figurativ, arsim muzikor, arsim fizik dhe shëndetësor/sport dhe aktivitete sportive, lëndë në të cilat mësohet për teknologjinë informatike, mësim praktik dhe të tjera.



Në **87% të shkollave fillore të cilat realizojnë mësim në më shumë gjuhë mësimore**, këshillat shkollorë janë me përbërje të përzier etnike. Në shkollat e mesme **të cilat realizojnë mësim në më shumë gjuhë mësimore të gjithë këshillat shkollorë** janë me përbërje të përzier etnike.

Hapa të mëtutjeshëm për avancimin e integritimit ndëretnik në arsim

- **Të thellohet bashkëpunimi i MASH-it me vetëqeverisjen lokale dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit** në mënyrë që të rritet numri i shkollave që do të dërgojnë të dhëna për aktivitetet e realizuara për integrim ndëretnik në arsim dhe për përpilimin e strategjive lokale për integrim ndëretnik në arsim;
- **Të realizohen trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional** të cilët nuk janë të trajnuar për realizimin e aktiviteteve për integrim ndëretnik në arsim;
- **Të vazhdohet me forcimin e kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror**, përmes sistemit të vendosur të trajnimeve të vazhdueshme.